

TETORI

MUAJI I NDËRGJEGJËSIMIT PËR KANCERIN E GJIRIT

Tetori, në të gjithë botën është muaji i ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit është një fushatë vjetore ndërkombëtare që synon të shpërndajë informacion dhe të edukojë njerëzit për rëndësinë e shëndetit të gjirit, për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit të gratë dhe vajzat në të gjithë botën.

Çdo vit, kjo fushatë fillon më 1 tetor dhe përfundon më 31 tetor.

Fushata organizohet edhe për të mbledhur fonde për kërkime shkencore për zbulimin e shkaqeve, parandalimin, diagnozën dhe trajtimin e këtij kanceri.

Fushata gjithashtu ofron informacion dhe mbështetje për femrat që janë të prekura nga kanceri i gjirit.

Aktualisht nuk ka njohuri të mjaftueshme për shkaqet e kancerit të gjirit, prandaj zbulimi i hershëm i sëmundjes mbetet guri themelor i kontrollit të kancerit të gjirit. Kur kanceri i gjirit zbulohet herët, ekzistojnë mundësitë që kanceri i gjirit të shërohet.

Në vitin 1993, Fondacioni i kërkimeve mbi kancerin, themeloi fjongon rozë si simbol të kancerit të gjirit, edhe pse kjo nuk ishte hera e parë që kjo fjongo u përdor për të simbolizuar kancerin e gjirit; në vjeshtën e vitit 1991, Fondacioni Susan G. Komen kishte shpërndarë fjongo rozë për pjesëmarrësit në një garë në Nju Jork për të mbijetuarit e kancerit të gjirit. Që atëherë, fjongoja rozë u bë simboli ndërkombëtar i ndërgjegjësimit ndaj kancerit të gjirit dhe i mbështetjes së personave që e vuanin atë.

Çdo Tetor me qindra e mijëra produkte të pajisura me fjongon rozë, apo të ngjyrosura me rozë, shërbejnë si simbolikë dhe shiten me qëllim që një pjesë e vogël e të ardhurave të grumbulluara të jepet si donacion për të mbështetur kërkimet apo fushatat ndërgjegjësuese të kancerit të gjirit.

Për më tepër shiko: Kanceri i gjirit te <http://www.ishp.gov.al/shendeti-riprodhues/>

